



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE

# *Kushtetuta ime*



doracak shpjegues për fëmijë



E drejta e autorit © Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

ISBN: 9789928309945

Ky botim u mundësua me mbështetje nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

*Shënim: Opinionet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë botim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)*



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confederation suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Agjencia Zviceriane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC**

## **Hyrje**

**Kjo është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e shpjeguar në një gjuhë të thjeshtë për të gjithë fëmijët.**

**Ajo është si një hartë që na tregon se si duhet të jetojmë së bashku, cilat janë vlerat, të drejtat dhe detyrat tona, dhe si funksionon shteti ynë.**

**Le ta njohim më mirë Kushtetutën tonë, pasi duke e njohur dhe respektuar atë, kuptojmë se gjithsecili prej nesh ka një rol të rëndësishëm për ta bërë Shqipërinë një vend më të mirë!**



## **Çfarë është Kushtetuta**

**Kushtetuta është si guri i themelit për një shtëpi.**

**Imagjino një çast sikur po ndërton një shtëpi të re dhe po vendos gurin e parë të themelit, pastaj një tjetër, e kështu me rradhë. Nëse guri i themelit është i fortë dhe i qëndrueshëm, atëherë shtëpia nuk rrëzohet lehtë dhe është e sigurt për të gjithë.**

## **Kushtetuta e vendit tonë**

Kushtetuta e Shqipërisë është si një libër i rëndësishëm vlerash dhe rregullash që:

-Na tregon se cilat janë të drejtat tona dhe se si na i garanton shteti ato, si duhet të sillemi, çfarë është e drejtë ose e gabuar, si dhe se si funksionon shteti ynë

-është si një udhëzues për vendin tonë dhe na ndihmon të jetojmë në paqe e drejtësi.

**Kur u krijua Kushtetuta jonë?**

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë  
u miratua më 28 nëntor të vitit 1998  
me votim nga i gjithë populli.**



## **Kushtetuta e vendit tonë**

Kushtetuta e Shqipërisë është ligji kryesor i vendit tonë. Aty gjejmë rregullat kryesore të cilat ndihmojnë që Shqipëria të jetë një vend i drejtë dhe i sigurt për të gjithë. Kur ne i respektojmë ato, vendi ynë bëhet më i fortë, ashtu si një shtëpi e cila qëndron e palëkundur mbi themelin e saj.

Nëse heqim gurin e themelit, shtëpia rrëzohet. Po kështu, nëse nuk respektojmë Kushtetutën, vendi mund të ketë shumë probleme dhe nuk do të funksionojë mirë.

Guri i themelit e mban shtëpinë të qëndrueshme, po kështu dhe Kushtetuta ndihmon që të gjithë të ndihen të sigurt dhe të kenë të drejta të barabarta.

## **Pse është e rëndësishme Kushtetuta?**

Imagjino që të gjithë po luajmë një lojë në shkollë, por askush nuk i di rregullat! Dikush mund të bëjë gjithçka që dëshiron dhe të mos e ndihmojë skuadrën e tij. Për këtë arsye, përpara se të fillojë loja, të gjithë biem dakord për disa rregulla që do të na ndihmojnë të luajmë më mirë dhe në mënyrë të ndershme.

Kushtetuta është si rregullat e lojës për Shqipërinë, që ndihmon të gjithë shqiptarët të dinë çfarë është e drejtë dhe se si të sillen.

## **Pse është e rëndësishme Kushtetuta**

Shembuj nga jeta e përditshme për të kuptuar Kushtetutën:

**-E drejta për arsimim:**

Kushtetuta thotë që të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkollë në shkollë dhe të jenë të sigurt. Shkolla na ndihmon të mësojmë shumë gjëra. Atje bëhemi të aftë dhe të gatshëm për të ndihmuar të tjerët e për të ndërtuar të ardhmen tonë.

**-Barazia përpara ligjit dhe trajtimi me dinjitet:** Fëmijët, ashtu si edhe të rriturit, kanë të drejta të barabarta. Ata duhet të trajtohen me respekt dhe dinjitet, pa asnjë dallim e paragjykim. Askush nuk duhet t'i lëndojë ose t'i trajtojë padrejtësisht fëmijët.

**-Liria e shprehjes:**

Në Shqipëri, Kushtetuta thotë që ne kemi të drejtë të themi atë që mendojmë dhe të kemi mendimin tonë. Imagjino që po vizaton diçka që e pëlqen shumë dhe dikush thotë që nuk ke të drejtë ta bësh. Kushtetuta na jep lirinë të kemi mendimet tona dhe t'i ndajmë ato, por gjithmonë me respekt për të tjerët.

Pra, Kushtetuta e Shqipërisë është shumë e rëndësishme, pasi na tregon si të jetojmë së bashku, të respektojmë njëri-tjetrin dhe të kontribuojmë për një Shqipëri më të mirë për të gjithë.

# Përmbajtja e Kushtetutës

**Teksti i Kushtetutës sonë përmban:**

**-Një pjesë hyrëse që në gjuhën e ligjeve quhet Preambul;**

**-tetëmbëdhjetë pjesë ku renditen të drejtat dhe liritë themelore, detyrat tona, dhe rregullat e organizimit të shtetit tonë.**

**I gjithë teksti përmban 183 rregulla,  
të cilat në gjuhën e ligjeve quhen nene.**

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia  
ore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa  
si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka  
rë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

Në Vlorë më

Pas fjalëve  
Bëra, me të cilat  
kë cilin ndodhet s  
të me një të  
sot të bëhet në

Handwritten text in Arabic script, including the name "Hacari" and some numbers.

Ummülkümü Hacari  
1875

J. Karabunan

Abdi  
Abas Delver

Zihni Abbas Karima

Hacari

15/28 të Gjeshtës së tretë 1328/1912.  
... tha L. Kuyetari Bmail Komit  
tegori rrenkan e math në  
At Shqipëria, të gjithë delija  
venduan që Shqipëria me  
vehte, e lirë e e marramur.

# Preambula

Amberg

veli kare,

Kedhep

Shqipëria

Shqipëria  
Cajpat

## **Pjesa hyrëse**

Kushtetuta jonë nis me një zotim të rëndësishëm e shumë kuptimplotë të të gjithë popullit shqiptar. Kjo deklaratë quhet Preambula e Kushtetutës.

Në Preambul deklarohe se:

**NE, POPULLI I SHQIPËRISË,**

-krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale,

-me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut,

-me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare,

-me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror,

-me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar,

-me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit,

**-VENDOSIM KËTË KUSHTETUTË.....”**

# Pjesa 1

## Parimet themelore




## **Parimet themelore**

Në rregullat ose nenet e para, Kushtetuta flet për vlerat kryesore të shoqërisë dhe të bashkëjetesës sonë. Këto quhen parime themelore dhe shërbejnë si baza e Kushtetutës.

### **Kjo pjesë shpjegon se:**

- Në Shqipëri vendimet i merr populli;
- Shqipëria është një vend i pavarur, demokratik ku ekzistojnë shumë parti;
- territori i Shqipërisë është i paprekshëm;
- të gjithë ne jemi të rëndësishëm dhe gëzojmë dinjitet, të drejta dhe liri të barabarta;
- mbrojtjen e të drejtave kombëtare e gëzojnë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të vendit tonë;
- jemi të lirë të kemi mendime dhe opinione të ndryshme e të shumëllojshme politike, t'i shprehim e t'i mbrojmë ato;
- bashkëjetesa, mirëkuptimi dhe respekti për njëri-tjetrin, edhe pse të ndryshëm, janë të rëndësishme;
- është detyrë e të gjithëve ne, të rritur dhe fëmijë, të ruajmë zakonet, traditat dhe trashëgiminë e të parëve tanë;
- duhet të kemi kujdes të veçantë për gjuhën shqipe, dhe ne kemi për detyrë ta duam dhe ruajmë këtë gjuhë të dëlirë e të bukur.



Pjesa 2  
Të drejtat  
dhe liritë themelore



## ***Të drejtat dhe liritë themelore***

Ne gëzojmë të drejta dhe liri themelore. Shteti ka detyrimin të na i garantojë ato dhe të na mbrojë nëse këto të drejta dhe liri na shkelen.

Kushtetuta shprehet se të drejtat dhe liritë themelore, janë:

### **-TË PANDASHME:**

ato janë të lidhura ngushtë me të qenit njeri dhe ne i gëzojmë sepse jemi qenie njerëzore

### **-TË PATJETËRSUESHME:**


të cilat nuk ja kalojmë dot dikujt tjetër, as duke i shitur dhe as duke i dhuruar

### **-TË PACËNUESHME:**

ato nuk duhet të na cenohen dhe duhet të na mbrohen

**Të drejtat dhe liritë shkruhen, përveç Kushtetutës, edhe në ligje**

**Kujdes: Liria e secilit nga ne mbaron aty ku fillon liria e tjetrit!**



Disa nga të drejtat  
dhe liritë themelore  
të garantuara nga  
Kushtetuta jonë



## **Disa nga të drejtat tona**

### **€ drejta për të jetuar:**

**Çdo person ka të drejtë të jetojë dhe askush nuk mund t'ia marrë këtë të drejtë.**


Shembull: Nëse dikush vret një person, pra, kryen një vrasje, shteti e dënon atë.



### **€ drejta për kujdes shëndetësor:**

**Çdo fëmijë ka të drejtë për ndihmë mjekësore kur ai ka nevojë për të, çka do të thotë se sa herë që sëmuret, shteti ia mundëson këtë ndihmë.**

Shembull: Kur sëmuresh, mjekët kujdesen për të të vizituar dhe shëruar. Kjo është e drejta jote për kujdes shëndetësor, me qëllim që të kesh një mendje dhe trup të shëndetshëm.



## **Barazia përpara ligjit:**

**Pavarësisht nëse jemi djem ose vajza, nëse i përkasim një komuniteti që flet një gjuhë tjetër, nëse kemi një besim fetar të caktuar, ose nëse kemi aftësi ndryshe, ne, të gjithë, kemi të drejta të barabarta.**



Shembull: Imagjino sikur në fillim të vitit shkollor në klasën tënde ka ardhur një nxënëse e re. Ajo flet një gjuhë tjetër dhe nuk e njeh shumë mirë gjuhën shqipe. Pavarësisht të gjithë kësaj, ajo duhet të trajtohet si të gjithë fëmijët e tjerë, pra me respekt dhe pa paragjykime. Të gjithë jemi të barabartë, pavarësisht nga gjuha që flasim ose ku jetojmë.

## **Ndalimi i trajtimit çnjerëzor:**

**Çdo njeri dhe çdo fëmijë, ka të drejtë të trajtohet me dinjitet dhe të mos lëndohet në qenien e tij, pra në trup dhe në mendje. Rrahja dhe çdo formë dhune ndaj fëmijës, qoftë edhe nga prindërit ose mësuesit, ndalohet nga Kushtetuta.**

Shembull: Imagjino sikur të kesh bërë një veprim të gabuar në shkollë dhe sapo kthehesh në shtëpi babai të flet shumë ashpër për gabimin e bërë. Në një moment nxehjeje ai të thotë se meriton një dënim shumë të rëndë dhe të godet. Kujdes! Dhuna ndaj fëmijëve dhe ndaj çdo personi, pra, çdo formë keqtrajtimi ndaj njëri-tjetrit në familje ose jashtë saj, është e ndaluar nga Kushtetuta dhe dënohet me ligj.

## **€ drejta për të qenë i lirë:**

**Çdokush ka të drejtë të zgjedhë vendin ku do të ketë shtëpinë e tij, ose vendin që dëshiron të vizitojë apo të shkojë për pushime, në Shqipëri apo jashtë saj.**

Shembull: Imagjino që nënës tënde i është ofruar një vend pune në një qytet tjetër dhe e gjithë familja jote duhet të zhvendoset për të banuar e jetuar në atë qytet. Ti dhe familja jote jeni të lirë të zgjidhni qytetin ku doni të jetoni.

## **€ drejta e privatësisë:**

**Çdokush prej nesh ka të drejtën e privatësisë së tij, e drejtë e cila përfshin jo vetëm komunikimin me gojë ose me shkrim, por edhe privatësinë e banesës.**



Kujdes: Askush nuk mund të bëjë publike pa dëshirën tënde foto të tuat, të dhënat e tua personale ose komunikimet e tua me të tjerët, dhe as t'i keqpërdorë ato. Ti ke të drejtën të ndihesh i mbrojtur dhe të gëzosh privatësinë në shtëpinë tënde. Çdo fëmijë dhe çdo person ka të drejtë të ketë një vend ku të ndihet i sigurt.

## **Liria e ndërgjegjes dhe e fesë:**

**Ne jemi të lirë të kemi besimin tonë fetar, i cili mund të jetë ai i prindërve ose i zgjedhur nga vetë ne. Përkatësia e besimit fetar nuk mund të përdoret për të trajtuar ndryshe një fëmijë. Po kështu, çdo fëmijë mund të zgjedhë të mos ketë një besim fetar.**

Kujdes: Duhet të respektojmë mendimet dhe besimet fetare të gjithsecilit. Askush nuk mund të na detyrojë të kemi besimin dhe mendimet e tyre fetare.

## **Liria e shprehjes ose e fjalës:**


**Jemi të lirë të mendojmë dhe kemi të drejtë të themi atë që mendojmë. Por, kujdes, edhe shprehjet dhe fjalët duhet të respektojnë dhe të mos lëndojnë të tjerët.**

Shembull: Imagjino që je në një lojë me shokët dhe secili mund të thotë një ide për lojën që do të luani. Secili ka të drejtë të thotë mendimin e tij dhe të dëgjohet. Kjo është e drejta jote për të folur dhe për të thënë atë që mendon dhe e ndien, por gjithmonë duke respektuar të tjerët.

## **€ drejta për arsim:**

**Të gjithë kanë të drejtë të shkojnë në shkollë dhe të mësojnë për botën rreth tyre. Arsimi është shumë i rëndësishëm për të na ndihmuar të bëhemi qytetarë të denjë të Shqipërisë dhe botës.**

Shembull: Disa prej nxënësve në klasën tënde nuk kanë mundësi të blejnë librat shkollorë. Shkolla ua garanton atyre pa pagesë. Pavarësisht të ardhurave familjare, çdokush ka të drejtë të shkollohet.



## **Të drejta të lidhura me mjedisin:**

**Mjedisi është shumë i rëndësishëm që çdo fëmijë të rritet i shëndetshëm, prandaj Kushtetuta i ka kushtuar vëmendje. Kushtetuta na jep të drejtë të informohemi për gjendjen e mjedisit.**

Shembull: Pranë shkollës suaj është ndërtuar një fabrikë, e cila shkakton ndotje të ajrit. Klasa juaj i drejtohet bashkisë së qytetit, duke kërkuar informacion për ndotjen e shkaktuar dhe duke shprehur shqetësim për këtë. Edhe ne mund të japim kontributin tonë për të ruajtur mjedisin ku jetojmë.

## **€ drejta e pronës private:**

### **Prona private mbrohet nga Kushtetuta.**



Edhe ti si fëmijë ke të drejtë të jesh pronar i sendeve të tua, ashtu si prindërit e tu janë pronarë të sendeve të tjera, siç është shtëpia, makina etj. Ekonomia e vendit tonë bazohet tek e drejta e pronës.

## **€ drejta për një familje:**

### **Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë një familje që e do dhe kujdeset për të.**

Kujdes: Sa herë kemi nevojë, ajo që na gjendet pranë është familja. Prindërit, familjarët dhe të afërmit tanë janë gjithmonë të pranishëm për ne. Familja na jep siguri dhe mbështetje dhe ndihmon që të rritemi të lumtur. Prandaj, shteti ka detyrimin të sigurojë mbrojtje të veçantë për familjen.



## **€ drejta e informimit:**

**Kushdo ka të drejtë të marrë informacion për veprimet dhe dokumentet e shtetit.**

Shembull: Nëse të duhet një informacion për një veprim ose për një dokument të shkollës, ti ke të drejtë ta kërkosh dhe ta marrësh atë. Kushtetuta shprehet se kjo e drejtë, pra, e drejta e informimit, është e garantuar prej saj.

## **€ drejta për një proces të rregullt ligjor:**

**Kur shkelen të drejtat, të gjithë qytetarët, përfshirë fëmijët, mund t'i drejtohen policisë ose gjykatës. Dinjiteti ynë duhet të respektohet në çdo rast.**



Shembull: Kur shkojmë në gjykatë, kemi të drejtë që gjyqtari të na dëgjojë, që avokati të na mbrojë, që të sjellim dëshmitarë e të marrim prova dhe, në fund, të marrim një vendim nga gjykata. Në vendimin e gjykatës tregohet se si është zgjidhur çështja jonë dhe kush ka të drejtë.

## **€ drejta e votës:**

**Kur mbushim 18 vjeç, kemi të drejtë të votojmë dhe të votohemi. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.**

Ne fitojmë të drejtën për të votuar ata që ne mendojmë se qeverisin në mënyrë të drejtë dhe të ndershme. Vota jonë, pra, pjesëmarrja në zgjedhje, luan një rol të rëndësishëm për të bërë më të mirën për komunitetin dhe vendin tonë. Edhe ne vetë kemi të drejtë të votohemi për të qenë pjesë e qeverisjes. Këtë të drejtë fëmijët e gëzojnë edhe në qeverinë e nxënësve.

## **€ drejta për t'u organizuar:**

**Ne kemi të drejtë të bashkohemi dhe të organizohemi me njëri-tjetrin për çfarëdo qëllimi të ligjshëm, si në shkollë, por edhe jashtë saj.**

Në shkollën tënde nxënësit janë ftuar të jenë pjesë e klubeve të ndryshme kulturore, si, për shembull, “Klubi i teknologjisë” apo “Klubi i librit”. Çdo fëmijë dhe i rritur ka të drejtë të bashkohet në organizime të ngjashme.

## **Mbrojtja e veçantë e fëmijëve:**

**Kushtetuta parashikon një mbrojtje të veçantë për fëmijët që duhet të garantohet nga shteti, pra duke ofruar më shumë mbrojtje për ta.**

**Sipas saj, çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna dhe keqtrajtimi.**

**Çdo fëmijë ka të drejtë të mbrohet nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht nëse është nën moshën 14 vjeç. Fëmijët në përgjithësi nuk mund të angazhohen në punë që dëmtojnë shëndetin, moralin ose vënë në rrezik jetën ose zhvillimin e tyre.**

Shembull 1: Një fëmijë që ka mbushur 16 vjeç mund të punojë në dyqanin e prindërve të tij, pra, lejohet të angazhohet në punë gjatë kohës së tij të lirë, por kujdes, ai mund ta bëjë këtë vetëm nëse kjo nuk e pengon atë për të bërë mësimet ose për të pasur kohë për të pushuar, për të luajtur apo për t'u zbavitur me shokët e tij. Angazhimi i tij në punë nuk duhet të dëmtojë shëndetin ose zhvillimin e tij.

Shembull 2: Një fëmijë 14 vjeç detyrohet nga prindërit të kërkojë lëmshë në rrugë. Kjo është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

## **Avokati i Popullit**

**Për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe të rriturve në vendin tonë shërben një avokat i të drejtave të njeriut që quhet - Avokati i Popullit. Ai nuk është si avokati që na mbron kur ne shkojmë në gjykatë, por garantohet nga Kushtetuta dhe mbron të drejtat tona nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të shtetit.**



Për të mësuar më shumë mbi rolin e Avokatit të Popullit dhe si t'i drejtohem atij shkojmë tek <https://www.avokatipopullit.gov.al/>

## **Detyrimet tona**

Përveç të drejtave, ne kemi edhe detyrime që na ndihmojnë të jetojmë së bashku në harmoni. Disa nga detyrimet më të rëndësishme janë:

### **Respektimi i Kushtetutës dhe i ligjeve:**

Ato janë hartuar për të na mbrojtur të gjithëve. Ne duhet t'i respektojmë ato për të jetuar në paqe dhe siguri.

### **Respekti për të tjerët:**

Të gjithë kanë të drejta, dhe ne duhet të respektojmë njëri-tjetrin, të mos ofendojmë ose lëndojmë të tjerët, pavarësisht nga dallimet mes nesh.


### **Kujdesi për mjedisin:**

Shqipëria është një vend i bukur, me natyrë të mrekullueshme. Ne kemi detyrën të mos ndotim mjedisin që na rrethon dhe duhet ta mbrojmë atë.

### **Taksat dhe tatimet:**

Prindërit tanë paguajnë taksa dhe tatime, të cilat formojnë buxhetin e shtetit dhe shteti i përdor ato për të garantuar të drejtat tona.





Pjesa 3  
Shteti dhe  
institucionet  
e tij

## **Shteti dhe qeverisja**

### **Çfarë është Shteti?**

Shteti është si një familje shumë e madhe ku jetojnë shumë njerëz. Ai ndihmon që gjithçka të shkojë mirë, që të kemi shkolla, spitale, rrugë dhe rregulla që na mbrojnë të gjithëve.

Shteti është ndarë në pjesë të ndryshme që punojnë së bashku për të bërë jetën më të mirë për të gjithë.

### **Si drejtohet shteti?**

#### **Tri pjesët kryesore të Shtetit:**

Shteti përbëhet nga tri pjesë kryesore, që në gjuhën e ligjeve quhen pushtete.

Ato janë:

- pushteti ligjvënës (Kuvendi),
- pushteti ekzekutiv (Qeveria)
- pushteti gjyqësor (Gjykatat).

Secili pushtet ka detyrat e tij të ndara nga pushtetet e tjera. Kjo ndarje detyrash njihet si "ndarja e pushteteve"

Pavarësisht se janë të ndara dhe të pavarura, pushtetet ndërveprojnë me njëri-tjetrin, pasi janë pjesë të të njëjtit shtet.

## **Si na ndihmon shteti?**

**Shteti ka për detyrë të ndihmojë qytetarët dhe të sigurojë që të gjithë të kenë një jetë të mirë. Disa nga mënyrat se si shteti na ndihmon janë:**

### **1.Mbrojtja e njerëzve:**

Shteti na siguron që policia të garantojnë rendin në vend me qëllim që të gjithë të ndihen dhe të jenë të sigurt.

### **2.Shërbimet shëndetësore:**

Shteti siguron që të kemi spitale dhe mjekë që kujdesen për shëndetin tonë.

### **3.Shkollat:**

Shteti siguron që çdo fëmijë të mund të mësojë e të shkojë në shkollë dhe të ketë një të ardhme më të mirë.

### **4.Rrugët dhe qytetet:**

Shteti kujdeset për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe qyteteve, ruajtjen e mjedisit, trashëgiminë kulturore, në mënyrë që të lehtësojë jetesën tonë të përbashkët në komunitet.

### **5.Kujdesi për personat në nevojë:**

Shteti përkujdeset për personat në nevojë, si për shembull, të moshuarit, fëmijët pa prindër, dhe personat me aftësi ndryshe.



## **Kuvendi**

(Pushteti ligjvënës)

Ai krijon ligjet bazuar në Kushtetutë. Ligjet janë si rregullat e lojës. Ato na tregojnë çfarë është e drejtë ose jo, dhe se si duhet të sillemi.

## **Qeveria**

(Pushteti ekzekutiv):

Qeveria kujdeset që ligjet të zbatohen dhe që njerëzit të jetojnë dhe ndërveprojnë sipas rregullave.

## **Pse është e rëndësishme të kuptojmë ndarjen e pushteteve**

### **Gjykatat**

(Pushteti gjyqësor):

Gjykatat vendosin nëse ligjet janë zbatuar si duhet. Ato ndihmojnë secilin nga ne, kur na shkelen të drejtat, të marrim drejtësinë sipas ligjit. Kujdes: Të mos harrojmë se të gjithë jemi të barabartë përpara ligjit


Parimi i ndarjes së pushteteve është shumë i rëndësishëm, pasi nuk lejon që dikush të ketë të gjitha vendimet në dorë dhe në këtë mënyrë shmang abuzimin me pushtetin.

Kjo bën që:

- Rregullat të vendosen në mënyrë të drejtë.
- Rregullat të zbatohen mirë.
- Konfliktet të zgjidhen pa favorizime dhe të drejtat tona të respektohen.

Shembull: Njësoj si në klasë kur detyrat ndahen mes nxënësve dhe në këtë mënyrë asnjë prej tyre nuk ka epërsi ndaj të tjerëve.





Disa nga  
institucionet e  
rëndësishme  
kushtetuese

## **Presidenti**

Në krye të shtetit shqiptar qëndron Presidenti i Republikës, i cili përfaqëson të gjithë popullin. Ai është edhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Presidenti i Republikës ka disa detyra, si:

-Presidenti shpall miratimin e ligjeve;

-cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor;

-emëron disa figura të rëndësishme të shtetit, si, për shembull, disa gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, rektorët e universiteteve, etj.;

-jep dekorata për qytetarët me merita dhe kontribute të veçanta.



## **Kuvendi**

Shqipëria është një republikë parlamentare. Parlamenti në Shqipëri quhet Kuvendi, i cili, për nga vetë emri, është vendi ku diskutohen çështjet e shtetit.

Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur nga populli. Deputetët në Kuvend miratojnë ligjet e vendit, pra, rregullat për shoqërinë dhe komunitetin tonë.

Në Kuvend diskutohen problemet e ndryshme të vendit, si, për shembull, përmirësimi i rrugëve, shërbimi në spitale, ndihma për njerëzit në nevojë, respektimi i të drejtave, etj.

Kuvendi kontrollon qeverinë për t'u siguruar që ajo po punon mirë dhe po bën gjërat që ka premtuar.



## **Qeveria**

**Këshilli i Ministrave ose Qeveria punon për nevojat dhe përparësitë për zhvillimin e vendit, merr vendime të rëndësishme për të drejtuar vendin dhe planifikon për të ardhmen e tij.**

**Qeveria drejtohet nga Kryeministri dhe një numër i caktuar ministrash. Ministrat kujdesen për fusha të ndryshme të jetës së përditshme, secili me një detyrë të veçantë, si, për shembull, për edukimin, shëndetësinë, financat, ekonominë, sigurinë etj.**

**Në organet qeverisëse punojnë nëpunësit publikë, të cilët zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.**

## **Qeverisja Vendore**

**Për të qenë sa më afër qytetarëve, Kushtetuta njeh edhe qeverisjen vendore, si: bashkitë (dhe/ ose komunat) dhe qarqet kujdesen dhe administrojnë në mënyrë autonome problemet e tyre vendore. Qeverisja vendore është qeveria e vogël afër nesh, e cila kujdeset për ofrimin e shërbimeve që lidhen me jetën tonë të përditshme.**

**Bashkia na shërben duke bërë që qytetet dhe fshatrat ku ne jetojmë dhe punojmë të jenë të pastra, të ndriçuara, të kenë shkolla e kopshte, dhe mjedise të sigurta për të gjithë.**

**Kryetari i bashkisë dhe këshilltarët bashkiakë zgjidhen çdo 4 vjet nga qytetarët e vetë bashkisë.**

## **Gjykatat**

**Pushteti gjyqësor është një pjesë e rëndësishme e vendit tonë, i cili përmes gjykatave jep drejtësi dhe kujdeset që të gjithë të respektojnë rregullat.**

**Nëse dikush mendon se i janë shkelur të drejtat, është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, mund t'i drejtohet gjykatës për të vënë në vend të drejtën e tij.**

**Kur dikush kryen vepra penale policia dhe prokuroria e dërgojnë çështjen në gjykatë për të dënuar autorët.**

**Gjykatat dhe gjyqtarët janë të pavarur. Ata u binden vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.**

## **Gjykata Kushtetuese**

**Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të garantojë respektimin e Kushtetutës. Ajo njihet ndryshe si “Roja e Kushtetutës”.**

**Gjykata Kushtetuese sigurohet që veprimet e tre pushteteve -(i) Kuvendit; (ii) Presidentit dhe Qeverisë; (iii) gjykatave, -të jenë në përputhje me Kushtetutën.**

**Shembull: Nëse Kuvendi nxjerr një ligj që nuk respekton të drejtat e fëmijëve ose qytetarëve të tjerë, Gjykata Kushtetuese e anulon atë ligj. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të vihen në diskutim nga asnjë pushtet tjetër.**

**Çdonjëri nga ne, edhe vetë fëmijët, mund t'i drejtohen drejtpërsëdrejti Gjykatës kur të drejtat tona kushtetuese janë shkelur.**



Për të mësuar më shumë mbi rolin dhe funksionet e Gjykatës Kushtetuese, dhe si t'i drejtohem asaj shkojmë tek <https://www.gjk.gov.al/>

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**GJYKATA KUSHTETUESE**

## **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

RSH. Gjykata Kushtetuese

Kushtetuta ime : doracak shpjegues për fëmijë / Gjykata  
Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. - Tiranë :

Kristalina-KH, 2024.

40 f. : me il. ; 10.5 x 14.5 cm.

Ky botim u mundësua me mbështetje nga Agjensia Zviceriane  
për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

ISBN 9789928309945

1.E drejta kushtetuese 2.Të drejtat e njeriut 3.Botime për  
fëmijë 4.Shqipëri

342.4(496.5) (0.053.2)

Shtypur në shtypshkronjën Kristalina-KH